



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3319/9 prot.

Datë 08.01.2026

V E N D I M

Nr.29/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.01.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik Mine Lloshi p.f në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-56462-07-28-2025, me objekt “Loti 2 “Shërbim i lavanderisë për Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi, Vlorë”, me fond limit: 8,322,960.58 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

Ankimues:

Operatori ekonomik Mine Lloshi p.f me NIPT L61418501V dhe adresë: Lagjja nr.14, Shkozet, objekt me nr.pasurie 3/76/ND, zona kadastrale 8515, Durrës

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe

funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.07.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-56462-07-28-2025, me objekt “Loti 2 “Shërbim i lavanderisë për Qendrën e Arsimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi, Vlorë”, me fond limit: 8,322,960.58 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 08.09.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankim.

II.3. Në datën 16.09.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

-“NDRRIN Laundry & Textile” SHPK	5,147,261.83	lekë	skualifikuar
- “Kombi Invest” SHPK	6,587,394.6	lekë	skualifikuar
- Lek Cukaj P.F	6,587,394.6	lekë	skualifikuar
-“Abi’s” SHPK	6,906,139.5	lekë	skualifikuar
-Mine Lloshi P.F	7,906,812.55	lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 16.10.2025 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr. 1459/2025 ku vendosi:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Kombi Invest” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-56462-07-28-2025, me objekt “Loti 2 “Shërbim i lavanderisë për Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi, Vlorë”, me fond limit: 8,322,960.58 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Abi’s” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Abi’s” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
4. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik Mine Lloshi P.F në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
5. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik Mine Lloshi P.F, duke e kualifikuar atë.
6. Ngarkohet zyra e financës, të kryej veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK.
7. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Abi’s” SHPK dhe Mine Lloshi P.F.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.5. Referuar raportit të auditit në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se me datë 27.10.2025 autoriteti kontraktor bazuar në vendimmarrjen më sipër të KPP ka rivlerësuar procedurën e prokurimit duke kualifikuar operatorin ekonomik Mine Lloshi P.F si më poshtë:

-“NDRRIN Laundry & Textile” SHPK	5,147,261.83	lekë	skualifikuar
- “Kombi Invest” SHPK	6,587,394.6	lekë	skualifikuar
- Lek Cukaj P.F	6,587,394.6	lekë	skualifikuar
-“Abi’s” SHPK	6,906,139.5	lekë	skualifikuar
-Mine Lloshi P.F	7,906,812.55	lekë	kualifikuar

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor (pa dokumenta provues bashkëlidhur mbi datën e kërkesës për dorëzimin e dokumentacionit) ky i fundit shprehet se: *“Me përfundimin e zbatimit të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor dhe heqjes së pezullimit nga ana e KPP-së, KVO vijoj me kërkesën online drejtuar operatorit ekonomik “Mine Lloshi” p.f mbi dorëzimin fizik të dokumentacionit provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike (origjinal ose fotokopje me origjinalin) përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit.”*

II.7. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se me datë 10.11.2025 operatori ekonomik Mine Lloshi P.F ka paraqitur pranë këtij të fundit dokumentacionin fizik provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.

II.8. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se me datë 12.11.2025 autoriteti kontraktor ka rivlerësuar procedurën e prokurimit nga ku rezulton si më poshtë:

-“NDRRIN Laundry & Textile” SHPK	5,147,261.83	lekë	skualifikuar
- “Kombi Invest” SHPK	6,587,394.6	lekë	skualifikuar
- Lek Cukaj P.F	6,587,394.6	lekë	skualifikuar
-“Abi’s” SHPK	6,906,139.5	lekë	skualifikuar
-Mine Lloshi P.F	7,906,812.55	lekë	skualifikuar

II.8.1. Operatori ekonomik Mine Lloshi P.F rezulton i skualifikuar për arsyet si vijon:

□ *Nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, piken 2.3.3 pasi nuk ka paraqitur Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Përgjegjësin e Shërbimit dhe punëtorët në lavanderi. Me konkretisht operatori ekonomik ne dokumentacionin e dorezuar ka paraqitur listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (ESig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin shtator 2025 por nisur nga percaktimet ne kete kriter duhej te paraqiste listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave për Përgjegjësin e Shërbimit dhe punëtorët në lavanderi e cila perkon me listpagesen e muajit korrik 2025.*

□ *Nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, piken 2.3.4 pasi me dokumentacionin e paraqitur ne përmbushje te ketij kriteri konstatohet qe ne faturen elektronike Nr 3/2025 Dt 21.08.2025 te paraqitur per te vertetuar disponimin e makinerise “Makinë larëse në të thatë (me kapacitet të barabartë ose mbi 10 kg)” nuk evidentohet qe kjo makine larese te jete me kapacitet te barabarte ose mbi 10 kg, pra rrjedhimisht OE nuk ka provuar qe disponon “makineri lares ne te thate” me specifikimet teknike te kerkuara ne kete kriter te DST.*

II.9. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se me datë 17.11.2025 është publikuar njoftimi i anulimit për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.10. Në datën 18.11.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6095 dhe me nr. 3319 prot., datë 18.11.2025 e operatorit ekonomik Mine Lloshi P.F për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-56462-07-28-2025, me objekt “Loti 2 “Shërbim i lavanderisë për Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi, Vlorë”, me fond limit: 8,322,960.58 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Pergendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik Mine Lloshi P.F, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.11. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3319/1 prot., datë 19.11.2025.

II.12. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike.

II.13. Përmes shkresës me nr. 181/3 rpot., datë 19.11.2025 protokolluar me tonën me nr. 3318/2 prot., datë 20.11.2025 me lëndë “Kallzim zyrtar për veprime të paligjshme gjatë administrimit të procedurave së prokurimit me objekt Loti 1 “Loti 1 “Shërbim i lavanderisë për Akademinë e Forcave të Armatosura, në Garnizonin “Skënderbej”, Tiranë”: Loti 2 “Shërbim i lavanderisë për Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi, Vlorë” dhe kërkesë për hetim administrativ drejtuar autoritetit kontraktor dhe për të cilin ka vënë në dijeni dhe KPP shprehet se: “

Me datë 02.12.2025 përmes shkresës me nr. 3688/9 prot., datë 17.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3318/7 prot., datë 04.12.2025 është ngarkuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e ankesave elektronike akti mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues Mine Lloshi P.F, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës duke argumentuar si vijon:

Me këtë shkresë paraqes formalisht kallezimin tim administrativ dhe paralajmërimin për ndjekjen e procedurave penale ndaj përfaqësuesve të KVO të Operatorit të Blerjeve të Pergendruara, lidhur me atë që konsideroj si një veprimtari të koordinuar, të qëllimshme dhe të paligjshme, në kundërshtim me ligjin dhe në cenim të barazisë së pjesëmarrësve në tender dhe të së drejtës sime ligjore për fitimin e kontratave publike.

Kam aplikuar në procedurat e prokurimit nr. REF-56460-07-28-2025 dhe REF-56462-07-28-2025 me datë 08.09.2025, duke dorëzuar ofertën dhe dokumentacionin përkatës, në përputhje të plote me kërkesat ligjore dhe dokumentet standarde të tenderit.

Kam qene skualifikuar ne menyre te padrejte dhe arbitrare nga Komisioni i Vleresimit të Ofertave, pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnje argumentim teknik apo administrativ te arsyeshëm.

Duke ushtruar te drejten ligjore, kam paraqitur ankim prane KPP, e cila me vendimin e saj unanim të datës 16.10.2025 ka pranuar ankesen dhe ne ushtrim te kompetencave te saj ka urdheruar KVO per kualifikimin e ofertes time. Theksoj qe ky vendim i KPP është i detyrueshëm, ekzekutiv dhe i menjehershëm për autoritetin kontraktor.

Mënyra e menaxhimit te thirrjes për dorezimin e dokumenteve, njoftimi ditën e premte ora 11:01 dhe mbyllja ditën e hënë e afati në mënyrë qe të kufizohej aftësia ime për dorezim efektiv, krijimi i nje suate artificiale dhe tendencioze për te bllokuar dorëzimin ne kohë, sjellja e punonjësve gjate procesit te administrimit dhe menyra e padrejte sesi eshte ndërtuar skualifikimi i dytë vijues tregojne qartë se procedura esht manipuluar me vetëdije. Kjo sjellje bie drejtperdrejt ndesh me nenin 258 te Kodit Penal, qe ndeshkon shkeljen e barazise së pjesemarrësve ne tendera, si dhe me nenin 258/b, qe sanksionon cdo devijim te qellimshëm nga regullat e prokurimit publik, perfshire paracaktimin e rezultatit.

E di shumë mire, dhe kete nuk po e kontestoj, qe ligji ju jep mundesine formale te kryeni nje skualifikim te dyte sic tashme e keni bere, por po aq mire e dini edhe ju se kjo e drejte nuk është dhe nuk mund te jete nje licence per abuzim, as nje mjet per te deformuar vullnetin e ligjit dhe per te anashkaluar vendimet e organeve te pavarura.

Vendimi juaj eshte ndertuar mbi arsye banale, mbi pretendime qesharake, mbi detaje te sajuara posaçërisht per te justifikuar nje skualifikim qe ne origjine eshte i motivuar keq, i pabazuar, tendencioz dhe krejtësisht abuziv.

Le te jemi te qarte:

nëse KPP më jep te drejte edhe nje here, cdo persëritje e ketij skenari do te konsiderohet dukshem shkelje e rende dhe e vetedijshme e ligjit, e sanksionuar sipas Kodit Penal, me pasoja te dretperdrete administrative, disiplinore dhe penale per secilin pergjegjes.

Nga ana tjetër, perdorimi i pozicionit publik per te fabrikuar arsye banale per skualifikim, zvarritja me qëllim e procedures duke shtyre lidhjen e kontrates ose per te ndikuar padrejtësisht ne procesin e vleresimit, perben shperdorim detyre sipas nenit 248 te Kodit Penal, i cili i sanksionon aktet e ndermarra ne kundërshtim me ligjin me qellim cenimin e interesave te palëve.

Sjelljet e konstatuara krijojne nje tablo ku mund te konstatohet marrja e perfitimeve ose shperblimeve nga funksionare publike (korrupsion pasiv) dhe nje koordinim apo ndikim te dretperdrejte nga operatorët e tjerë per te manipular rezultatit e procedures (korrupsion aktiv) duke ngritur dyshime te bazuara per elemente te mundshem penal te parashikuar nga neni 259, si dhe nxitje te veprimeve te kunderligjshme te punonjesve publike, te parashikuara nga neni Ky nuk eshte nje paralajmerim formal, eshte nje angazhim i qarte se cështja do te ndiqet deri ne fund dhe pergjegjesia individuale e çdo punonjesi do te ngrihet perpara organeve kompetente. E drejta ime eshte e mbrojtur nga ligji dhe une do ta çoj deri ne fund. Pa bere anje akuze te drejtperdrejte ne këte faze, por duke u mbështetur ne faktet e dokumentuara qe disponoj dhe faktet per ndikimin e disa aktoreve te jashtem qe kanë influencuar vendimmarrjen, duke cenuar barazine dhe transparencen qe ligji e kerkon, ju paralajmeroj se cdo material, cdo komunikim, cdo nderhyrje dhe cdo praktike qe kam konstatuar gjate administrimit te dosjes do t'i paraqitet zyrtarisht organeve kompetente, sebashku me kerkesën per zhvillimin e nje hetimi te thelluar administrativ mbi mënyrën se si

eshte menaxhuar kjo procedure dhe rolin individual te secilit prej personave pergjegjes duke filluar nga Anetaret e KVO dhe deri te titullarja e ketij institucioni.

Ky hetim do te kerkohet me qellimin e verifikimit te ligjshmerise se cdo vendimi, veprimi apo mosveprimi, dhe per te vendosur cdo funksionar perballe pergjegjesise se tij ligjore.

Konkretisht

- *Titullaren: Znj. Arlinda Pogaj,*
- *Anëtarët e KVO-se*
- *Anëtarët e KSHA-së*

• Anëtarët e pranimit te dokumentacionit

Nëse hetimi administrativ konfirmon qofte edhe nje element te vetëm te veprimeve te paligjshme qe do ti parashtroj, çdo person pergjegjes do te vihet perball pergjegjesise se plote penale dhe ligjore, pa anje mundesi shmangie, dhe eshtja do te ndiqet deri ne instancat më te larta, duke perfshire SPAK-un. Kjo nuk ishte paralajmerim i thjeshte, por nje njoftim zyrtar qe çdo manipulim, çdo vonese apo do tentative tjeter per te deformuar proceduren do te kete pasoja te dretperdrejta ligjore.”

II.14. Me shkresën e datës 26.11.2025 me lëndë “Informacion shtesë për ankesën nr. A/2025/6095” protokolluar me tonën me nr. 3319/2 prot., datë 27.11.2025 operatori ekonomik Mine Lloshi P.f ka dërguar në KPP listëpagesat e periudhës Janar-Tetor 2025.

II.15. Me shkresën nr. 3891/1 prot., datë 26.11.2025 me lëndë “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 3319/3 prot., datë 27.11.2025 autoriteti kontraktor i ka thyer përgjigje operatorit ekonomik Mine Lloshi P.F lidhur me shkresën e sipërcituar duke vënë në dijeni edhe KPP-në.

II.16. Me datë 02.12.2025 përmes shkresës me nr. 3688/12 prot., protokolluar me tonën me nr. 3319/4 prot., datë 03.12.2025 është ngarkuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e ankesave elektronike vendimi i KSHA nr.141/2025 datë 27.11.2025 mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues Mine Lloshi P.F, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës duke argumentuar si vijon:

II.

Komisioni i shqyrtimit të ankesës

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga njësia e prokurimit:

ARSYETON:

II.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Mine Lloshi” pf mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij lidhur me mos dorëzimit të E-SIG sipas përcaktimeve në Dokumentat e Tenderit, KSHA arsyeton se:

Në Dokumentet e Tenderit, Shtojca 9, pika 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, nënpika 2.3.3. e Kapacitetit teknik përcaktohet:

“Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 4 (katër) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

Nr	Personeli	Nr.punonjësve
1	Përgjegjës shërbimi	1 (një)
2	Punëtorë në lavanderi	2 (dy)
3	Shofer	1(një)
	TOTALI	4 (katër)

Për përmbushjen e këtij kriteri, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin sipas më poshtë:
 Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Përgjegjës të Shërbimit dhe punëtorët në lavanderi.

Për punonjësin e kërkuar në pikën 1, duhet të paraqiten dokumentat:

- Kontratë individuale pune përkatëse, e vlefshme.
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 1 (një) vit.

Për punonjësit e kërkuar në pikën 2, duhet të paraqiten dokumentat:

- Kontratë individuale pune përkatëse, e vlefshme.

Për punonjësin e kërkuar në pikën 3, duhet të paraqiten dokumentat:

- Kontratë individuale pune përkatëse, e vlefshme.
- Leje Drejtimi, për mjetin e kërkuar, në përputhje me Legjislacionin në fuqi

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Në dokumentacionin fizik provues për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes "Mine Lloshi" pf, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e natyrës së objektit të prokurimit, specifikimeve teknike, frekuencës së ekzekutimit të kontratës/ava, që do të lidhen dhe termave të referencës, hartuar nga AK.

Në tabelën e mësipërme është përcaktuar numri minimal i punonjësve, të cilët vlerësohen të nevojshëm për kryerjen e proceseve të punës, të cilat përfshijn shërbimi i lavanderisë, si më poshtë: Përgjegjësi i shërbimi ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit të lavanderisë, dhe të gjitha proceseve të punës, të përfshirë në këtë proces, duke mbajtur përgjegjësi për zbatimin e

objektit të prokurimit, në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara. Vitet e eksperiencës për përgjegjësin e shërbimit, janë vendosur me qëllim që AK të sigurohet se përgjegjësi i shërbimit ka eksperiencë të mjaftueshme për të përballuar situata reale dhe aftësi praktike në zgjidhjen e tyre, për të ndërtuar protokolle funksionale dhe cilësi të qëndrueshme të realizimit të shërbimit, organizimin e stafit dhe zbatimin e të gjitha proceseve të shërbimit, në përputhje me kërkesat e akademisë së forcave të armatosura. Kjo përvojë e kërkuar është një tregues që përgjegjësi i shërbimit ka njohuri praktike për produktet dhe pajisjet që do të përdoren gjatë ekzekutimit të kontratës/ave, proceset e larjes, kërkesat higjeno-sanitare që duhet të zbatohen.

Disponimi i punëtorëve në lavanderi siguron AK që ofertuesit zotërojnë personelin e nevojshëm për të kryer proceset e larjes, tharjes, hekurosjes, paketimit, në kohë dhe me cilësinë e kërkuar.

Shoferi është i nevojshëm për të kryer proceset e marrjes dhe transportimit të materialeve nga autoriteti kontraktornë lavanderi dhe anasjelltas.

Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës në të cilat duhe të përmbushë ky shërbim.

Është vlerësuar që stafi teknik (përgjegjësi i shërbimit dhe punonjësit në lavanderi) të jenë të punësuar pranë operatorit ekonomik të paktën muajin e fundit, për të garantuar kapacitetin real dhe të menjëhershëm të tij për të përmbushur objektin e kontratës. Kjo shmang përfshirjen e stafit fiktiv dhe siguron që personeli i përfshirë në realizimin e shërbimit objekt prokurimi është njohës i sistemeve dhe praktikave të punës së operatorit ekonomik, duke rritur cilësinë dhe sigurinë e zbatimit të kontratës/ave që do të lidhen gjatë vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.”

Në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 3 “Parime të përgjithshme”, përcaktohet:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

Në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 111 “Paraqitja e ankesës”, pika 2 parashikohet se: “Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për

të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën”.

Në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Neni 82, pika 5 ku përcaktohet se: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë: a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre, [...]”

Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Në nenin 41, pika 4, gërmat “b” dhe “c” “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në funksion të dëshmimit me atë të dokumentacionit provues, pas shpalljes paraprak për procedurën e prokurimit objekt ankimimi, konstaton se nga ky i fundit nuk është paraqitur listapagesa për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në

funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (*fuginë puntore*), në përputhje me kontratën objekt prokurimi.

KSHA gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk ka sjellë listëpagesën për muajin e fundit të kërkuar, por ka paraqitur një listëpagesë që i përket muajit pasues, pra një periudhë që nuk është e vlefshme për vlerësim, sepse nuk përmbush kërkesën e qartë të dokumenteve të tenderit, të cilat përcaktojnë se dokumentacioni duhet të pasqyrojë situatën aktuale deri në muajin e fundit para hapjes së ofertave. Listëpagesa e muajit vijues nuk garanton që situata e paraqitur lidhur me punësimin e punonjësve të kërkuar është në përputhje me periudhën e kërkuar, pasi dokumenti mund të përmbajë ndryshime në numrin e punonjësve, vlera të deklaruar apo elementë të tjerë që nuk pasqyrojnë gjendjen e detyrueshme për vlerësim. Pra, nuk plotësohet kriteri i kualifikimit, sepse dokumenti i dorëzuar nuk është ai i kërkuari dhe, si rrjedhojë, mungon dokumentacioni bazë që vërteton kapacitetin e ofertuesit në kohën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Ky devijim nuk mund të konsiderohet thjesht gabim teknik, pasi ndryshimi i periudhës së deklaruar mund të sjellë pasqyrim të ndryshëm të numrit të punonjësve, angazhimeve të tyre, apo të situatës së përgjithshme financiare të ofertuesit. Në këtë mënyrë, autoriteti kontraktor nuk mund të verifikojë gjendjen faktike të operatorit në kohën e duhur, kohë që është thelbësore për garantimin e konkurrencës së ndershme dhe trajtimin e barabartë të të gjithë pjesëmarrësve.

Për më tepër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se edhe gjatë fazës së paraqitjes së ankesës, ku operatori ekonomik ankimues mbështet pretendimet e tij në prova dhe fakte konkrete, sërish nuk ka paraqitur listëpagesën e kërkuar për muajin e fundit të deklaruar, para datës së hapjes së ofertave. Kjo tregon qartë se operatori ekonomik ankimues potencialisht ose nuk e disponon dokumentin për periudhën e kërkuar, ose nuk ka pasur mundësi ta posedojë atë në përputhje me kërkesat, ose gjendja faktike e stafit të tij në atë periudhë nuk përmbush kriteret e vlerësimit.

Në çdo rast, edhe pas dhënies së një mundësie të dytë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik, instrumenti i ankimit, për të provuar pretendimet në e tij në ankesë, ankimuesi nuk ka sjellë provën kryesore që do të dëshmonte përputhshmërinë me kriteret e kualifikimit. Kjo situatë konsolidon edhe më tej konstatimin dhe vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave se dokumentacioni i domosdoshëm mungon, dhe si rrjedhojë, kriteri i kualifikimit mbetet i paplotësuar.

Pra, për sa nuk ka plotësuar kriterin e detyrueshëm të kualifikimit lidhur me dorëzimin e listpagesës për periudhën e kërkuar, si në fazën fillestare të vlerësimit, ashtu edhe në fazën e ankesës. Mosplotësimi i këtij kriteri përbën përbën kusht për skualifikim.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Mine Lloshi” për mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij lidhur me makinën larëse në të thatë të kërkuar dhe dokumentacionin përkatës, KSHA vëren se:

Në Dokumentet e Tenderit, Shtojca 9, pika 2.2.4 e Kapacitetit teknik është përcaktuar se:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makineritë, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia minimale e kërkuar
1	Lavatrice/makine larëse (me kapacitet të barabartë ose mbi 20 kg secila)	Copë	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK
2	Makineri tharëse profesionale (me kapacitet të barabartë ose mbi 20 kg)	Copë	1 (një) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK
3	Makinë larëse në të thatë (me kapacitet të barabartë ose mbi 10 kg)	Copë	1 (një) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK
4	Makineri Hekurosëse (Rul) Profesional	Copë	1 (një)
5	Makineri Paketimi Profesionale për paketim inventar i bute	Copë	1 (një)

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit të lavandersisë dhe të gjitha proceseve të tij, si: larje, tharje, hekurosje, paketim.

Disponimi i këtyre mjeteve (lloji, sasia dhe pesha) është vendosur bazuar në proceset e punës të shërbimit objekt prokurimit, si dhe sasisë së parashikuar nga AK të materialeve që do të lahen, duke shërbyer si garanci e AK që shërbimi, objekt prokurimi do të kryhet me cilësi dhe konform të gjitha kërkesave të AK.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, përcaktohet:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

Në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 111 “Paraqitja e ankesës”, pika 2 parashikohet se: *“Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankuesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën”.*

Në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Neni 82, pika 5 ku përcaktohet se: *“Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë: a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre, [....]”*

Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Në nenin 41, pika 4, gërmat “ç” “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave lidhur me këtë pretendim të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, së pari shqyrtoi formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga ankimuesi. Në përmbushje të parashikimeve të Nenit 82, pika 1 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se "*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*", ankimuesi "Mine Lloshi" pf ka paraqitur formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ku në përmbushje të kërkesës së sipërcituar ka deklaruar ndër të tjera se:

"Makinë larëse në të thatë (me kapacitet mbi 10 kg) /copë 1 (dy)/Në pronësi, fatura nr 3/2025"

Në përmbushje të detyrimit sipas pikës 5 të Nenit 82 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë: a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre, (...)*", është dorëzuar dokumentacioni provues në koherencë me deklarinimet e bëra. Nga shqyrtimi i dokumentati "*faturë nr.3/2025*" për makinën larëse në të thatë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton në përmbajtje të saj nuk citohet asnjë lloj kapaciteti.

Referuar kriterit të sipërcituar ku ndër të tjera përcaktohet se: "*... Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet: dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë)*", konstatohet se ofertuesit kanë pasur disa mënyra për të dëshmuar kapacitetet e kërkuara të makinerive nëpërmjet disa dokumenteve të ndryshme. Në rastin konkret, shqyrtim ankimi, ankimuesi ka zgjedhur të paraqesë faturën përkatëse me anë të së cilës nuk ka arritur të dëshmojë kapacitetin e kërkuar për makinë larëse në të thatë dhe në këtë kontekst, kriteri specifik i përcaktuar sipas kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, konsiderohet i pa përmbushur.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Mine Lloshi” pf.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
4. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

II.17.Me shkresën nr. 7180/1 prot., datë 02.12.2025 me lëndë “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 3319/5 prot., datë 03.12.2025 i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik Mine Lloshi P.F në lidhje me shkresën me nr. 181/3 prot., datë 19.11.2025 me lëndë “Kallzim zyrtar për veprime të paligjshme gjatë administrimit të procedurave së prokurimit me objekt Loti 1 “Loti 1 “Shërbim i lavanderisë për Akademinë e Forcave të Armatosura, në Garnizonin “Skënderbej”, Tiranë”: Loti 2 “Shërbim i lavanderisë për Qendrën e Arsimit Profesional të Ushtarve, Bunavi, Vlorë”.

II.18. Informacionin për shqyrtimin e ankesës, autoriteti kontraktor e dërgoi në KPP edhe përmes shërbimit postar me shkresën nr. 3688/12 prot., datë 02.12.2025 i cili u protokollua me tonën me nr. 3319/6 prot., datë 04.12.2025 bashkëlidhur të cilit gjendet edhe dokumentacionin fizik i dorëzuar në autoritet kontraktor nga operatori ekonomik Mine Lloshi P.F si operator ekonomik i kualifikuar i pari sipas rivlerësimit të procedurës me datë 27.10.2025.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1 Lidhur me pretendimin e operatori ekonomik Mine Lloshi P.F për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: *“Nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, piken 2.3.4 pasi me dokumentacionin e paraqitur ne përmbushje te ketij kriteri konstatohet qe ne faturen elektronike Nr 3/2025 Dt 21.08.2025 te paraqitur per te vertetuar disponimin e makinerise “Makinë larëse në të thatë (me kapacitet të barabartë ose mbi 10 kg)” nuk evidentohet qe kjo makine larese te jete me kapacitet te barabarte ose mbi 10 kg, pra*

rrjedhimisht OE nuk ka provuar qe disponon “makineri lares ne te thate” me specifikimet teknike te kerkuara ne kete kriter te DST. KPP vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, Loti 1, pika 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “2.3. Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.4 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makineritë, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia minimale e kërkuar
1	Lavatrice/makine larëse (me kapacitet të barabartë ose mbi 20 kg secila)	Copë	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK
2	Makineri tharëse profesionale (me kapacitet të barabartë ose mbi 20 kg)	Copë	1 (një) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK
3	Makinë larëse në të thatë (me kapacitet të barabartë ose mbi 10 kg)	Copë	1 (një) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK
4	Makineri Hekurosëse (Rul) Profesionale	Copë	1 (një)
5	Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash	Copë	1 (një)

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.1.2. Në shtojcën 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën III, “Shkaqet e përjashtimit”, Pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, parashikohet :

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin elektronik, në përmbushje të kriterit të vecantë për kualifikim të pikës 2.3.4 të dokumentave të tenderit si më sipër situar (të cilat përmbushen fillimisht përmes deklarimeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit) në fazën e ofertimit operatori ekonomik ka paraqitur në sistem dokumentacionin si më poshtë:

-Formluarin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik Mine Lloshi P.F të me datë të dorëzimit të deklaratës 08.09.2025 ku në pjesën III, Pika B “Deklarata për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar si më poshtë:

Makinëri dhe pajisje				
Nr	Emri i njetit	Njësia	Sasia	Statusi
1	Lavatrice/makinë larëse (me kapacitet mbi 20 kg secila)	copë	2 (dy)	Në pronësi, dogana nr.
2	Makinëri tharëse profesionale (me kapacitet mbi 20 kg)	Copë	1 (një)	Në pronësi, dogana nr.
3	Makinë larëse në të thatë (me kapacitet mbi 10 kg)	copë	1 (dy)	Në pronësi, fatura nr.

4	Makinë Hekurorese (Rul) Profesionale	Copë	1 (një)	Në pronësi, fatura nr.
5	Makinëri Paketimi Profesionale për paketim rrobash	Copë	1 (një)	Në pronësi, fatura nr.

Emri, Mbiemri Mine Lloshi

Firma

Vula

Data e dorëzimit të deklaratës 08.09.2025



III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.5. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 2 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “ 2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e

kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Nisur nga pretendimet më sipër të ankimuesit, mbi skualifikimin e tij me arsyen se: *““Nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, piken 2.3.4 pasi me dokumentacionin e paraqitur ne përmbushje te ketij kriteri konstatohet qe ne faturen elektronike Nr 3/2025 Dt 21.08.2025 te paraqitur per te vertetuar disponimin e makinerise “Makinë larëse në të thatë (me kapacitet të barabartë ose mbi 10 kg)” nuk evidentohet qe kjo makine larese te jete me kapacitet te barabarte ose mbi 10 kg, pra rrjedhimisht OE nuk ka provuar qe disponon “makineri larese ne te thate” sipas specifikimeve teknike te përcaktuara ne kete kriter te DST.”* Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik Mine Lloshi P.F, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, me datë të deklarimit 08.09.2025 ku për përmbushjen e kriterëve të vecanta të kualifikimit të cilat si fillim përmbushen përmes deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ka kryer deklarimet si në pikën III.1.3 të këtij vendimi. Operatori ekonomik Mine Lloshi P.F, ka qenë operatori ekonomik i kualifikuar i pari sipas rivlerësimit të procedurës së kryer nga autoriteti kontraktor në zbatim të vendimit të KPP me nr.1459/2025 datë 16.10.2025. Në këto kushte bazuar në nenin 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të aktit rregullator të mësipërm dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së me shkresën me nr. 3688/12 prot., datë 02.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 3319/5 prot., datë 04.12.2025, bashkë me

dokumente të tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, në brendësi të të cilit gjendet dokumentacioni për përmbushjen e kriterit të vecantë për kualifikim në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik lidhur me: “Makinë larëse në të thatë (me kapacitet të barabartë ose mbi 10 kg)”, konkretisht, Fatura nr. X datë 21.08.2025 me shitës V. K dhe me blerës Mine Lloshi P.F në të cilën përcaktohet zëri makinë larëse në të thatë sic kërkohet në dokumentet e tenderit në kriterin 2.3.4 por pa specifikuar kapacitetin (të barabartë ose mbi 10 kg). Në këtë kuadër KPP gjykon se ankimuesi Mine Lloshi P.F me dokumentacionin e mësipërm ka dhënë indicie mbi plotësimin e kriterit duke dorëzuar faturën që dëshmon disponimin e pronësisë së makinerisë si dhe llojin e saj ndërsa për vërtetimin e kapacitetit, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të kërkonte sqarime në përputhje me parashikimet e nenit 92 pika 1 të *lex specialis* në të cilin përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.” Autoritetit kontraktor për një shqyrtim të drejtë dhe objektiv të çështjes pa cënuar përmbajtjen e ofertës dhe duke mos pasur si qëllim ndikimin në vlefshmërinë e tyre, sa herë lind nevoja për sqarime mbi ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, ka detyrimin ligjor që në mbështetje të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, t’i drejtohet me kërkesë për sqarim operatorëve ekonomikë në përmbushje të qëllimit të *lex specialis* të parashikuar në nenin 2 të tij. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që operatorët ekonomikë të ofrojnë produkte të cilat janë konform kërkesave të vendosura nga ai vetë dhe që japin garanci për përmbushjen me sukses të kontratës. Duke qenë se mungesa e evidentimit në faturë të kapacitetit mbajtës të barabartë ose mbi 10 kg e ka vënë autoritetin kontraktor përballë dyshimeve mbi përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga kjo makineri autoriteti kontraktor ka patur në dispozicion momentin procedural të parashikuar nga neni 92 i *lex specialis* për të kërkuar sqarime mbi mënyrën e përmbushjes së kërkesave të tij me qëllim vlerësimin sa më të drejtë të ofertave pasi ankimuesi ka paraqitur faturën nr. X datë 21.08.2025 dokument i cili provon pronësinë e makinës larëse në të thatë ndërsa për vërtetimin e specifikave të tjera si kapaciteti në rastin konkret i cili jo domosdoshmërisht mund të jetë i shprehur në faturë duhet të kërkonte sqarime. Paraqitja e kërkesave për sqarim drejt operatorëve ekonomikë në këto raste është veprim imperativ dhe jo alternativ dhe si rrjedhojë duke qenë se autoriteti kontraktor me mos veprim ka shkelur nenin 92 pika 1 të *lex specialis* duhet t’i drejtohet ankimuesit me kërkesën për sqarim siç normativa e sipërcituar parashikon, për të gjykuar në mënyrë shterruese me dokumentacion provues mbi plotësimin apo jo të kapacitetit mbajtës.

Sa më lart pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Mine Lloshi P.F për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: “Nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, pikën 2.3.3 pasi nuk ka paraqitur Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Përgjegjësin e Shërbimit dhe punëtorët në lavanderi. Me konkretisht operatori ekonomik në dokumentacionin e dorëzuar ka paraqitur

listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (ESig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin shtator 2025 por nisur nga përcaktimet në këto kriter duhet të paraqiste listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave për Përgjegjësin e Shërbimit dhe punëtorët në lavanderi e cila perkon me listëpagesën e muajit korrik 2025.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, Loti 2, pika 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “2.3. Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.3 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

2.3.3 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 4 (katër) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

Nr	Personeli	Nr.punonjësve
1	<i>Përgjegjës shërbimi</i>	1 (një)
2	<i>Punëtorë në lavanderi</i>	2 (dy)
3	<i>Shofer</i>	1(një)
	TOTALI	4 (katër)

Për përmbushjen e këtij kriteri, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:
Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Përgjegjësin e Shërbimit dhe punëtorët në lavanderi.

Për punonjësin e kërkuar në pikën 1, duhet të paraqiten dokumentat:

- Kontratë individuale pune përkatëse, e vlefshme.
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 1 (një) vit.

Për punonjësit e kërkuar në pikën 2, duhet të paraqiten dokumentat:

- Kontratë individuale pune përkatëse, e vlefshme.

Për punonjësin e kërkuar në pikën 3, duhet të paraqiten dokumentat:

- Kontratë individuale pune përkatëse, e vlefshme.
- Leje Drejtimi, për mjetin e kërkuar, në përputhje me Legjislacionin në fuqi

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.2.2. Në shtojcën 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën III, “Shkaqet e përjashtimit”, Pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, parashikohet :

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

III.2.3. Nga verifikimi në sistemin elektronik, në përmbushje të kriterit të vecantë për kualifikim të pikës 2.3.3 të dokumentave të tenderit si më sipër cituar (të cilat përmbushen fillimisht përmes deklarimeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit) në fazën e ofertimit operatori ekonomik ka paraqitur në sistem dokumentacionin si më poshtë:

-Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik Mine Lloshi P.F të me datë të dorëzimit të deklaratës 08.09.2025 ku në pjesën III, Pika B “Deklarata për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar si më poshtë:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
-----------	-----------

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.

PunonjësPo [☒] Jo [☐]

Nëse, po, numri i punonjësve: 5

Profili i punonjësve

Përgjegjes shërbimi- E L1

Punonjes lavanderie – B K

Punonjes lavanderie – Rr R

Punonjes lavanderie – L A

Shofer – G B

Makineri e mjetePo [☒] Jo [☐]

Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

Mjet transporti: KARRY COWFISH me

kontrate qiraje financiare(leasing) rep/kol



III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor,

social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 3. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.2.5. “Në nenin 26 pika 2 dhe 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimi publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërket të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, nëpërmjet kriterëve për kualifikim, synohet siguri i ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e tenderit janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e

vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nisur nga pretendimet më sipër të ankimuesit, mbi skualifikimin e tij me arsyen se: *“Nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, piken 2.3.3 pasi nuk ka paraqitur Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Përgjegjësin e Shërbimit dhe punëtorët në lavanderi. Me konkretisht operatori ekonomik ne dokumentacionin e dorëzuar ka paraqitur listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (ESig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin shtator 2025 por nisur nga percaktimet ne kete kriter duhej te paraqiste listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave për Përgjegjësin e Shërbimit dhe punëtorët në lavanderi e cila perkon me listpagesen e muajit korrik 2025.”* Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik Mine. Lloshi P.F, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, me datë të deklaratës 08.09.2025 ku për përmbushjen e kriterëve të vecanta të kualifikimit të cilat si fillim përmbushen përmes deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ka kryer deklarimet si në pikën III.2.3 të këtij vendimi. Duke qenë se operatori ekonomik Mine Lloshi P.F, është operatori ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi sipas rivlerësimit të procedurës së kryer nga autoriteti kontraktor në zbatim të vendimit të KPP me nr.1459/2025 datë 16.10.2025, bazuar në nenin 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor ndër të tjera dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të aktit rregullator të mësipërm dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së me shkresën 3688/12 prot., datë 02.12.2025 i cili u protokollua me tonën me nr. 3319/6 prot., datë 04.12.2025, bashkë me dokumente të tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, në brendësi të të cilit gjendet dokumentacioni për përmbushjen e kriterit të vecantë për kualifikim në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik lidhur me: *“Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore i cili ka shërbyer si arsye skualifikimi konkretisht: Deklarata “ Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi” e operatorit ekonomik Mine Lloshi P.F për muajin shtator 2025.”*

KPP si fillim gjen me vend të sqarojë se ndryshe nga sa pretendon ankimuesi se: *“Në këtë rast data e hapjes së ofertave ka qenë data e dorëzimit efektivisht të dokumentacionit dhe dokumentacioni i dorëzuar nga shoqëria jonë përmbush plotësisht këtë kërkesë, duke siguruar listpagesën e muajit shtator 2025 e cila provon punësimin e të gjithë personelit aktual që do të realizojë shërbimin objekt prokurimi..... Praktikisht kjo do të thotë që data e vlerësimit të ofertave duke përfshirë edhe rishikimin pas ankimimit në KPP është referenca ligjore për të përcaktuar nëse operatori plotëson kriteret.....dorëzimi i listëpagesës së shtatorit është i ligjshëm, i mjaftueshëm dhe reflekton realitetin e përmbushjes së kriterit të punësimit.....Çdo pretendim për përdorimin e listëpagesës së korrikut 2025 nuk ka bazë ligjore dhe përbën një shkelje të hapur të parimit të trajtimit të barabartë dhe të drejtës për pjesëmarrje në tender duke cënuar të drejtën e operatorit për vlerësim të drejtë dhe objektiv”* ashtu sikurse kemi cituar më sipër bazuar në nenin 26 *“Formulari përmbledhës i*

vetëdeklarimit” pika 6, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik i cili pas fazës së vlerësimit kualifikohet i pari duhet që përpara publikimit të njoftimit të fituesit e nisjes së afateve të ankimit, të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të aktit rregullator të sipërcituar të cila janë deklaruar në shtojcën 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, dhe çfarë është e rëndësishme këto dokumenta duhet të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezultoi se me datë 08.09.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit që do të thotë ka hapur për vlerësim ofertat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Bazuar në parashikimet më sipër të aktit rregullator dokumentet provues të deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit duhet të provojnë gjendjen faktike të subjektit në momentin e ofertimit pra me datë 08.09.2025, datë në të cilën janë hapur për vlerësim ofertat dhe jo në kohën e dorëzimit të dokumentacionit fizik pranë autoritetit kontraktor.

Në këtë kuadër duke marrë shkas nga aryeja e skualifikimit të ankimuesit, dhe duke e ballafaquar me kriterin e vecantë të kualifikimit në pikën 2.3.3 të dokumenteve të tenderit i cilat si fillim përmbushet përmes deklarimeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga ankimuesi, si dhe dokumentacionin fizik të paraqitur nga ky i fundit në autoritet kontraktor për përmbushjen e këtij kriteri lidhur me Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Përgjegjësin e Shërbimit dhe punëtorët në lavanderi, KPP për të gjykuar mbi objektin e këtij pretendimi vlerëson ti drejtohet legjislacionit sektorial në fuqi mbi kontributet e sigurimeve shoqërore, konkretisht, ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Në nenin 10 pika 1 ligji i sipërcituar parashikon se “1. Personi juridik dhe fizik i detyruar për të paguar kontribute, për çdo periudhë, duhet të deklarojë, në formë elektronike, në organin tatimor të dhënat e detyrimeve për kontributet në total dhe për çdo individ. Po këtui, në nenin 11 gërma a dhe b, parashikohet se: “Deklarimet e parashikuara në nenin 10 dhe pagesa e kontributeve bëhen në afatet e mëposhtme:

a) nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër;

b) nga personat fizikë, përjashtuar personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes si dhe të punësuarit.” Referuar kriterit të hartuar nga autoriteti kontraktor muaji i fundit nga data e hapjes së ofertave (më 08.09.2025) për deklarimin e Listëpagesës së sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore sipas parashikimeve më sipër të legjislacionit sektorial është muaj korrik 2025. Ashtu sikurse po ky legjislacion parashikon se subjektet si personat juridik ashtu dhe ata fizik kanë detyrimin që për çdo periudhë të deklarojnë në organet tatimore detyrimet në total dhe për çdo individ të punësuar. Në këtë kuadër Komisioni gjykon se deklarimet mbi sigurimet shoqërore janë të dhëna të vazhdueshme që pasqyrojnë disponimin e stafit në secilën periudhë, të dhëna këto të

cilat mund të mos jenë statike apo të pa ndryshueshme nga njëra periudhë në tjetrën pasi operatorët ekonomikë për shkaqe nga më të ndryshmet, mund të bëjnë ndryshime në staf bazuar në praktikën e tyre të brendshme. Duke qenë se deklaratimet lidhur me pagesat e sigurimeve shoqërore janë të dhëna të vazhdueshme pasi subjektet janë të detyruar të deklarojnë në organe tatimore detyrimet për çdo periudhë, formulari e-sig i deklarimit të sigurimeve shoqërore i muajt shtator 2025 i paraqitur fizikisht nga operatori ekonomik Mine Lloshi P.F pranë autoriteti kontraktor i ka dhënë indicien këtij të fundit se edhe deklaratimet e muajve të mëparshëm përfshirë edhe ato të muajit korrik 2025 që përkon me kërkesën e autoriteti kontraktor janë kryer. Në këtë kuadër, meqenëse deklaratimet lidhur me pagesat e sigurimeve shoqërore janë të dhëna të vazhdueshme, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të kërkonte sqarime mbi deklaratimet e sigurimeve shoqërore për muajin korrik 2025 (*muaji i fundit nga data e hapjes së ofertave*) në përputhje me parashikimet e nenit 92 pika 1 të *lex specialis* në të cilin përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.” Ashtu sikurse jemi shprehur më sipër në këtë vendim, paraqitja e kërkesave për sqarim drejt operatorëve ekonomikë në këto raste është veprim imperativ dhe jo alternativ dhe si rrjedhojë duke qenë se autoriteti kontraktor me mos veprim ka shkelur nenin 92 pika 1 të *lex specialis* duhet ti drejtohet ankimuesit me kërkesën për sqarim sic normativa e sipërcituar parashikon për të gjykuar në mënyrë shteruese me dokumentacion provues mbi plotësimin apo jo të kriterit të sipërcituar.

Sa më lart pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik Mine Lloshi P.F në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-56462-07-28-2025, me objekt “Loti 2 “Shërbim i lavanderisë për Qendrën e Arsimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi, Vlorë”, me fond limit: 8,322,960.58 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik Mine Lloshi P.F dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër duke kërkuar sqarimet e duhura lidhur me arsyet e skualifikimit.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik Mine Lloshi P.F.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

